



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës  
Opština Priština – Municipality of Prishtina



## EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

**Dëgjimi publik për planifikimin e buxhetit për vitin 2026, mbajtur më 6.8.2025. i cili filloi në orën 14:00.**

**Në diskutim morën pjesë qytetarët:** Isa Rexha, Bujar Gashi, Valdet Hashani, Merita Kongjeli, Shqipe Gashi, Vjollca Zeqiri, Florie Musliu, Merita Kosmaqi, Drilon Morina, Bernard Gegaj, Liridona Hajdari, Adelina Ismaili, Shkurte Gerbeshi-Osmeni, Fikrie Ademi, Amire Dragusha, Besnik Krasniqi, Luljeta Bejta.

**Të pranishëm ishin edhe:** drejtori i shëndetësisë - Izet Sadiku, drejtoresha e financave - Valbona Makolli, shefi i Drejtorisë së Shëndetësisë, si dhe zyrtarë nga Drejtoria e Kulturës.

Diskutimin me qytetarë e kryesoi **Osman Bllaca**.

**Osman Bllaca:** Hapi diskutimin për bashkëbisedim

Gjatë muajit korrik, në Barilevë janë realizuar rreth 225 vizita, që përkthehen në mesatarisht rreth 10 vizita në ditë, ose 9.7 vizita për dy ditë. Drejtori ushtrues i detyrës së poliklinikës stomatologjike, doktor Bernard Gegaj, falënderoi për themelimin e poliklinikës dhe shprehu nevojën për zgjerimin e hapësirës së saj, duke pasur parasysh se një pjesë e objektit që më parë shërbente për poliklinikën, tashmë është në shfrytëzim nga Ministria e Punëve të Brendshme. Ai theksoi rëndësinë e zgjerimit të gamës së shërbimeve stomatologjike në Prishtinë, duke përfshirë edhe mundësinë e edukimit profesional për specialistët dhe stazhin obligativ për licencim. Gjithashtu u evidentua nevoja për rritjen e kapaciteteve teknike dhe hapësirë për të minimizuar ose eliminuar listat e pritjes për proteza, si për të moshuarit ashtu edhe për fëmijët. U përmend domosdoshmëria e pajisjes me kompjuterë në të gjitha njësitë ku ofrohen shërbime stomatologjike për përmirësimin e kontrollit të cilësisë dhe uljen e kostove për institucionin dhe qytetarët. Një tjetër kërkesë ishte trajnimi i asistentëve stomatologjikë në trajtimin e rasteve alergjike dhe dhënien e terapive intravenoze dhe intramuskulare. Në të ardhmen, planifikohet pajisja e sallës së kirurgjisë me rëntgen digjital me retrolarë për të lehtësuar intervenimet kirurgjikale pa nevojën e lëvizjes së pacientëve.

**Feim Osmani:** - ngriti çështjen e interesimit të drejtorisë lidhur me cilësinë e shërbimeve në Barilevë, duke theksuar se numri i banorëve që kërkojnë trajtim është i madh (rreth 2500-3000). Ai propozoi rritjen e informacionit dhe promovimin e shërbimeve të fizioterapisë në çdo qendër të

mjekësisë familjare, pasi shumë banorë nuk janë të informuar për ekzistencën e tyre. Osmani vuri në dukje nevojën për ofrimin e kujdesit në shtëpi, sidomos për të moshuarit dhe theksoi rëndësinë e një kampanje të mirëinformuar për qasjen më të lehtë të banorëve në këto shërbime.

**Izet Sadiku:** - theksoi nevojën për përmirësimin e reklamimit të shërbimeve, duke sjellë shembullin e procesit të dezinfektimit, ku bashkësitë lokale u informuan paraprakisht. Ai tregoi për rritjen e numrit të shërbimeve të ofruara nga viti 2022 deri më tani, duke përmendur pilot-projekte në shërbimet e logopedisë dhe fizioterapisë, të cilat nuk janë ende shërbime të rregullta në kujdesin parësor për shkak të udhëzimeve administrative. Megjithatë, për vitin e ardhshëm pritet punësimi i specialistëve në këto fusha, si dhe i punëtorëve socialë dhe psikologëve klinikë.

Në vazhdim, u diskutua edhe për arsyet pse disa pacientë nga Barileva preferojnë të vizitohen në QMF-në në Besi, ku ndryshimet e fundit në mjekë kanë për qëllim rikthimin e tyre në vendbanimet e tyre. Doktoresha Vjollca Zeqiri, specialiste e mjekësisë familjare dhe kordinatore e kontrollit të cilësisë, paraqiti disa kërkesa të rëndësishme për hapjen e këshillimoreve të menaxhimit të sëmundjeve kronike jongjitime në qendrat me fluks të madh pacientësh, si dhe për furnizimin me inventar të ri dhe pajisje teknologjike, përfshirë laptopë për ligjërata dhe rritjen e numrit të stafit të trajnuar, si dhe pajisjeve mjekësore të nevojshme.

**Merita Kongjeli - kryeinfermiere e kujdesit parësor:** - kërkoi rritje të buxhetit për kujdesin parësor, shtim të stafit dhe financim për trajnimet dhe certifikimet e infermierëve dhe farmacistëve. Ajo theksoi nevojën për investime në pajisje moderne për diagnostifikim dhe trajtim bazë, përmirësim të kushteve sanitare dhe higjienike, si dhe fonde për shërbime mobile dhe për organizimin e kampanjave të promovimit shëndetësor dhe edukimit profesional.

Në përfundim, Izet Sadiku nënvizoi se trajnimet duhet të realizohen përmes planprogramit të miratuar me odën përkatëse dhe nuk ishte e nevojshme të hapeshin debate të mëtejshme për këtë çështje.

*Debati përfundoi në orën 11:00.*

**Procesmbajtësi**

**Besarta Bekaj dhe Brikena Krasniqi**


**Kryesuesi i debatit**

**Osman Bllaca**



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës  
Opština Priština – Municipality of Prishtina



Dëgjimet publike për planifikimin e buxhetit për vitin 2026,  
6 Gusht, 2025  
Kryeqyteti - Prishtinë / Kuvendi Komunal

| Nr. | Emri/Name   | Mbiemri/Surname | Tiulli/Title              | e-mail           | Nënskrimi/Signature |
|-----|-------------|-----------------|---------------------------|------------------|---------------------|
| 1   | Isa         | Velis           | Shpirtak L.               |                  |                     |
| 2   | Shajri Comi | Seni            | Shajri S.                 | shajri@comi      |                     |
| 3   | Valdet      | Hakani          | Kryepitak                 | valdet.hakani    |                     |
| 4   | Merita      | Kongjeli        | Kryepitak Merita Kongjeli |                  |                     |
| 5   | Shajri      | Seni            | Shajri S.                 | shajri@comi      |                     |
| 6   | Volica      | Geprica         | Spee H.F.                 | volica.h.geprica |                     |
| 7   | Florie      | Musliu          | Artist                    |                  |                     |
| 8   | Merita      | Kongjeli        | Kryepitak Merita Kongjeli |                  |                     |
| 9   | Shajri      | Seni            | Shajri S.                 | shajri@comi      |                     |
| 10  | Shajri      | Seni            | Shajri S.                 | shajri@comi      |                     |

P.S \*Të dhënat tuaja personale do të përdoren vetëm për qëllime të evidencimit të pjesëmarrësve në konsultatën tuaj publike.  
\*Pjesëmarrësit janë të njohur se gjatë diskutimeve publike, do të fotografohen dhe do të publikohen!\*

| Nr. | Emri/Name   | Mbiemri/Surname | Titulli/Title | e-mail                    | Nënshkrimi/Signature |
|-----|-------------|-----------------|---------------|---------------------------|----------------------|
| 11  | Lindona     | Hyjdeni         | Informere     | lindona.hyjdeni@rks-gj.mn |                      |
| 12  | Adelina     | Osmani          | Informere     | adelina.osmani@rks-gj.mn  |                      |
| 13  | Shkurti     | Shkurti-Osmani  | Informere     | shkurti.osmani@rks-gj.mn  |                      |
| 14  | Fikete      | Ademi           | Informere     | fikete.ademi@rks-gj.mn    |                      |
| 15  | Amir        | Osmani          | Informere     | amir.osmani@rks-gj.mn     |                      |
| 16  | Besnik      | Osmani          | Informere     | besnik.osmani@rks-gj.mn   |                      |
| 17  | Lufeta Bajt | Bajt            | Informere     | lufeta.bajt@rks-gj.mn     |                      |
| 18  |             |                 |               |                           |                      |
| 19  |             |                 |               |                           |                      |
| 20  |             |                 |               |                           |                      |
| 21  |             |                 |               |                           |                      |
| 22  |             |                 |               |                           |                      |
| 23  |             |                 |               |                           |                      |
| 24  |             |                 |               |                           |                      |
| 25  |             |                 |               |                           |                      |
| 26  |             |                 |               |                           |                      |
| 27  |             |                 |               |                           |                      |
| 28  |             |                 |               |                           |                      |

P.S \*Të dhënat tuaja personale do të përdoren vetëm për qëllime të evidentimit të pjesëmarrësve në konsultim publik dhe nuk do të përdoren për qëllime tjera!

\*Pjesëmarrësit janë të njoftuar se gjatë diskutimeve publike, do të fotografohen!\*